



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Kom.Dh.Shk.II.nr.33/22

GJYKATA KOMERCIALE - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit nga Prishtina, me adresë, Prishtinë ndaj debitorit Zyra e Kryeministrit të Kosovës, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore – Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga debitori, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.116/18, datë 22.04.2020, më datë 01.09.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të debitorit Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.116/18, datë 22.04.2020, **PRISHET** dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe vendosje të njëjtës gjykatë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.116/18, datë 22.04.2020, e ka hedhur poshtë prapësimin e përfaqësuesit të debitorit Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, Avokatura Shtetërore – Ministria e Drejtësisë, të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr 534/17 të datës 13.11.2017, të Përmbartuesit Privat Fadil.I.Hoxha, si të pa afatshëm.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjorë ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i debitorit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin, që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se debitori, pranë përmbaruesit privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, në bazë të titullit përmbarimor aktgjykimit A.nr 1355/2012 i datës 26.05.2015, i plotfuqishëm me datë 16.06.2015 dhe i ekzekutueshëm me datë 28.10.2015 me të cilin ka kërkuar që të caktohet përmbarimi dhe të detyrohet menjëherë debitori Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës që të merr aktvendim me të cilin do të i lejohej paditësit çasje në të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara në lidhje me shpenzimet e bëra nga ish kryeministri H. Th dhe ish zëvendësministrat H.K, E.T, B.B, B.P, dhe M.K-L, gjatë periudhës kohore nga data 15.02.2011 e deri me datë 31.08.2012.

Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit, ka marr urdhrin P.nr 534/17 të datës 13.11.2017, me të cilin ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarues aktgjykimit A.nr 1355/2012 i datës 26.05.2015, i plotfuqishëm me datë 16.06.2015 dhe i ekzekutueshëm me datë 28.10.2015

Kundër urdhrin P.nr 534/17 të datës 13.11.2017, të Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, me të cilën është caktuar përmbarimi, debitori me datë 09.01.2018, ka ushtruar prapësim, duke shtuar se aktgjykimi në bazë të cilit është kërkuar përmbarimi është marr me shkelje të procedurave ligjore andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.116/18, datë 22.04.2020, ka vendos që ta hedh poshtë, prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr 534/17 të datës 13.11.2017 si të pa afatshëm. Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr 534/17 të datës 13.11.2017 debitori e ka pranuar me datë 18.11.2017, ndërsa prapësimin e ka ushtruar me datë 09.01.2018, dhe atë pas plot 46 ditëve, që do të thotë pas skadimit të afatit të paraparë ligjorë sipas dispozitave nga neni 70 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Për vendimin sikur në dispozitiv u bazua në nenin 73 të LPP-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u bazuar nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për shkak se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika k lidhur me nenin 107 par.1 të LPK-së, për të cilat shkelje aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet.

Në rastin konkret, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se në cilësinë e debitorit kemi të bëjmë me një institucion publik-Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

në Prishtinë, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore – organ i autorizuar për përfaqësime që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Fakti i tillë vërtetohet edhe nga prapësimi i ushtruar, ku është theksuar se debitori përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore. Në prezencën e këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që në lidhje me çdo veprim të ndërmarrë në këtë procedurë kontestimore në drejtim të palës paditëse, ta njoftojë Avokaturën Shtetërore, si organ i cili ka qenë i autorizuar të ndërmarrë veprime në emër dhe në dobi të debitorit. Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se Përmbaruesi Privat, Urdhrin për Përmbarim të datës 13.11.2017 e ka dorëzuar në adresë të Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës-Prishtinë, kur në fakt është dashur që ta njoftojë Avokaturën Shtetërore – Ministria e Drejtësisë, Prishtinë. Veprimet e tilla të ndërmarra nga gjykata e shkallës së parë janë në kundërshtim të plotë me dispozitën nga neni 107 par.1 të LPK-së, ku parashihet se *“Kur palën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor apo me prokurë, shkresa i dorëzohet përfaqësuesit ligjor, përkatësisht përfaqësuesit me prokurë”*. Si pasojë e këtyre lëshimeve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është dëmtuar interesi i debitorit, të cilës i është pamundësuar prapësimi brenda afatit ligjor.

Nga arsyet e cekura, Gjykata Komerciale gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura, të cilat duhet të eliminohen në ri procedurë, në atë mënyrë që gjykata të veprojë sipas vërejtjeve të paraqitura më lartë lidhur me zhvillimin e procedurës, ashtu që të vazhdojë procedurën duke u kujdesur për përfaqësimin e palëve, ashtu që në lidhje me çdo veprim të ndërmarrë t’i njoftojë palët e autorizuar dhe pastaj varësisht nga veprimet procedurale të ndërmarra të procedojë në funksion të vendosjes së drejtë dhe të ligjshme në këtë çështje kontestimore. Në çdo rast, veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitave të nenit 194, 208 dhe 209 pika (d) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP – së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.33./22, me datë 01.09.2022

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti